



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**IMPLEMENTIMI I SHËRBIMIT TË FISKALIZIMIT DHE MIRËMBAJTJE VJETORE**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Shërbimet e programimit për implementimin e sistemeve 72224100-2

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**3,000,000.00 (TRE MILION) LEKË PA TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanlizime Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

**Argumentimi i fondit limit :** Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar.

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin e ofertes , sipas shtojcës 1*

*b. Listën e cmimeve të sherbimeve , sipas shtojcës 2*

*c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit, (Shtojca 8)

Operatori duhet te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise ne Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit te kesaj kontrate.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet **2019, 2020 dhe 2021**, me nje vlere jo me te vogël se 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbime** të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe faturave tatimore te shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqes:

- ISO 9001 (për Standartin e Menaxhimit të Cilesisë) e perditesuar
- ISO 27001 (për Standartin e Sigurisë se Informacionit) e perditesuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron manaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë. Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës Nisur nga proceset e punës kritike, rendesise se shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës se tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara që garantojnë ISO për sistemin e manaxhimit të cilësisë dhe ISO për sigurinë e informacionit.

### **2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:**

- a) 4 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike etj).

Plotesimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si **“Ekspert të Certifikuar”** në zhvillim dhe implementim të zgjidhjes së ofruar.

*Kjo të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së Certifikatës së lëshuar nga një kompani e licensuar nga autoritetet përkatëse shtetërore. Kjo kompani të jetë vet prodhuesi i sistemit ose përndryshe të jetë e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të lëshuar atë lloj certifikate.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Qe te sigurohet aftesia per implementimin e kerkesave per ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteve , etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit

- b) Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (një) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Çertifikuar” ne perdorimin e zgjidhjes se ofruar.

*Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates se leshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vet prodhuesi i sistemit ose perndryshe te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te leshuar ate lloj certifikate.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Qe te sigurohet aftesia per implementimin e kerkesave per ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteve , etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit

- c) Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Çertifikuar” ne zhvillim dhe implementim te Programit te Faturim – Arketimit Flare Billing.

*Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates se leshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vet prodhuesi i sistemit ose perndryshe te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te leshuar ate lloj certifikate.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Qe te sigurohet aftesia per integrimin me Programin e Faturim – Arketim Flare Billing, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar te



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

pakten 1 person me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit

- d) Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e web sherbimeve dhe protokollit SOAP.

*Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates se leshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese.*

**Argumentim:** Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara. Nevojitet per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme dhe me sistemet e paleve te treta.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet te kete Autorizim Prodhuesi ose distributori per Programin e Faturim – Arketimi Flare Billing. Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Autorizimit se leshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vet prodhuesi i sistemit ose te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te leshuar ate lloj Autorizimi.

**Argumentim:** Duke qene se AK perdor sistemin Flare Billing, per te shmangur cdo incidinet gjate periudhes se integrimin te dy sistemeve, kerkohet qe kompania te vertetoj qe mund te punoj me systemin Flare Billing.

**2.4.2** Sistemi duhet te jete COTS (Commercial off-the-shelf). Ky sistem nuk duhet te kete kosto licensash per instalime ne ambient test, ambient zhvillimi dhe per shtimin e perdoruesve. Per te vertetuar kete kusht ofertuesit duhet te paraqesin:

- a. Autorizimi i Prodhuesit per implementim, mirembajtje dhe zhvillim i cili te specifikojë projektin, daten, adresen e qarte te prodhuesit dhe te bashkengjise certifikaten e regjistrimit te sistemit.
- b. deklaraten nga prodhuesi i sistemit ku percaktohet qarte menyra e licensimit te sistemit qe kerkohet te implementohet.
- c. deklarate nga prodhuesi qe sistemi/moduli eshte i integruar me modulet e tjera sic kerkohet ne specifikimet teknike duke i permendur sakte emrat e sistemeve apo moduleve me te cilat eshte i integruar dhe duke percaktuar qarte menyren dhe informacionin qe eshte i integruar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

**Argumentim:** Qe te sigurohet aftesia per implementimin e sistemit dhe bazuar ne proceset e punes kritike, rendesise se sherbimeve qe sistemi ofron kerkohet qe OE te ofroje nje sistem i cili eshte i gatshem dhe vetem do te implementohet.

**2.4.2 Operatori** Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.

**Argumentim:** Bazuar ne Ligjin Nr 87/2019 Për faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e te mirëmbajtesve të zgjidhjeve software-ike duhet që operatorët të cilët ofrojnë këtë shërbim duhet të jenë të licensuar dhe te regjistruar në regjistrin e prodhuesve ose te mirëmbajtesve software-ike te AKSHI-it.

**2.4.3 Operatori** Ekonomik duhet te paraqes propozimin teknik per permbushjen e specifikimeve teknike te kerkuara.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

*mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

I. Hyrje

Shoqëria rajonale Ujësjelles Kanalizime Durres pritet te gjeneroi rreth 132000 abonente. Bazuar ne Ligjin Nr 87/2019 Për faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e te mirëmbajtjesve të zgjidhjeve software-ike, Shoqëria rajonale UK Durres kerkon implementimin e nje programi fiskalizimi me integrim me programin e Faturim – Arketimi Flare Billing per te fiskalizuar faturat e abonenteve.

II. Programi i fiskalizimit

Funksionalitetet që duhet të ketë programi:

- a) Të jete i afte te fiskalizoje te gjithë faturat e abonenteve cdo muaj njeheresh
- b) Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Flare Billing. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi I faturimit Flare Billing dhe të fiskalizohen.
- c) Sistemi i fiskalizimit të dërgojë sistemit të faturimit Flare Billing të gjithë informacionin e nevojshëm mbi fiskalizimin e faturave.
- d) Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e Flare Billing si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.
- e) Të jetë i integruar me sistemin e Flare billing për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për arketimet e faturave.
- f) Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.
- g) Te jete i bazuar ne web
- h) Të përfshijë mirëmbajtjen e programit të fiskalizimit për 12 muaj.
- i) Afati i implementimit bashke me integrimin me Sistemin Flare Billing 5 dite nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.

Sipas vendimit nr:239 dt. 20/03/2020 bazuar në LIGJIN Nr. 87/2019 PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQERIA RAJONALE**  
**UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.**

Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- a) krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- b) vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- c) dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- d) lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- e) transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës fature individuale ose fature shoqëruese;
- f) ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- g) gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
- h) gjenerimin e kodit QR;
- i) printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- j) sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

sipas **LIGJ Nr. 2/2017 PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

Funksionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofrojë mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofrojë mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
7. Të mundesojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundesojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.
9. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.